ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA SHENDETESORE MENTALE HAREJA**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **SHMF-220-25-2278-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Lënda Furnizim me material higjenik Me numër të Prokurimit 003-2025**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" KIGA " SH.P.K.**
NUI	**810051946**
Adresa	**Sllatine e Madhe**
Vendi	**Fushe Kosove**
Kodi postar	**12000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ismail Shabani**
Adresa elektronike	**kigashpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**02.05.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	**Isuf Zejna**
Adresa e plotë	**St. Ferid Curri, E4, A1/9, Prishtina, 10000, Kosovo**
Numri i Telefonit	**+383 49 287454**
Numri i faks-it	**/**
Adresa elektronike	**zejna@rzzlaw.com**

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lënda Furnizim me material higjenik Me numër të Prokurimit 003-2025

I. KRONOLOGJIA E ÇËSHTJES

1. Autoriteti Kontraktues Qendra Shëndetësore Mentale Hareja (tutje: Autoriteti Kontraktues) ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull: "Lënda Furnizim me material higjenik Me numër të Prokurimit 003-2025". Kjo procedurë ishte kuotim i çmimit me vlerë të parashikuar prej 5,000 Euro. Aktiviteti i prokurimit ishte iniciar me datën 21.03.2025, dhe data e fundit për dorëzimin e ofertave ishte data 28.03.2025.

2. Operatori ekonomik Kiga ShPK (tutje: Parashtruesi i kërkesës), brenda afatit të përcaktuar, ka dorëzuar ofertën e vet duke i plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktauara në Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Së bashku me ofertën Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar edhe vërtetimin tatimor të datës 14.01.2025 i cili kishte vlefshmëri prej 90 ditësh.

3. Gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë ku ka kërkuar edhe vërtetimin tatimor. Parashtruesi i kërkesës ka ofruar vërtetimin e datës 16.04.2025 i cili tregonte se parashtruesi i kërkesës ka marrëveshje për shlyerjen e borxheve me ATK.

4. Me datën 18.04.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar dokumentin B 58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me anë të së cilit Parashtruesin e kërkesës e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, kinse për shkak se marrëveshja e dorëzuar me ATK-në ishte pas datës së inicimit të aktivitetit të prokurimit, duke abstrahuar faktin se Parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar vërtetimin tatimor të datës 14.01.2025 i cili ishte me validitet 90 ditor dhe i kishte plotësuar kushtet që fare të mos kërkohet vërtetim tjetër tatimor.

5. Duke mbetur i pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe duke e konsideruar këtë eliminim si të paligjshëm, Parashtrusi i kërkesës ka vendosur që të paraqes këtë mjet juridik administrativ, për të kundërshtuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 18.04.2025, përkatësisht për të kundërshtuar arsyet e eliminimit të ofertës së Parashtruesit të kërkesës.

II. BAZA JURIDIKE PËR APROVIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

6. Çështja e plotësimit të kritereve të pranueshmërisë së ofertuesve është e rregulluar në detaje me nenin 65 [Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve] në të cilin nen, paragrafi 4 përcakton: "Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik [...] 4.8. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë".

7. Më tutje kjo çështje është sqaruar dhe interpretuar edhe nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (tutje: KRPP) ku në interpretimin e datës 22.11.2022 sqarohet: "KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 "aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;" Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi "aktualisht" nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë "të pranueshëm" për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë "të pranueshëm" kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë "Deklaratën nën betim" me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "i pranueshëm" OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë."

8. Nga interpretimi i cekur si më lart, kuptohet se Parashtruesi i kërkesës Kiga ShPK ka plotësuar të gjitha kushtet e tenderit, pasi që në datën e publikimit të njoftimit për kontratë, ka pasur vërtetimin tatimor valid dhe nuk ka ekzistuar asnjë arsye për eliminimin tanë. Duke marrë parasysh këtë, autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 59 kur ka eliminuar ofertën tonë, pasi që në këtë dispozitë përcaktohet qartë se: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Për më

tepër në nenin 52 par 3 përcaktohet: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike."

9. Duke eliminuar ofertën e Parashtruesit të kërkesës, Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 7 [Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi], në të cilën përcaktohet: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente." Në rastin konkret, duke na eliminuar si ofertë e papërgjegjshme, përkundër se ishim oferta më e lirë në këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues përveç diskriminimit tonë si operator, bënë edhe dëmtimin e buxhetit të institucionit pasi që përzgjedh për fituese një ofertë dukshëm më të shtrenjtë sesa kjo e Parashtruesit të kërkesës dhe në këtë mënyrë vepron në shkelje të nenit 1 dhe 6.

Prandaj, duke marrë përbazë të gjitha argumentet e theksuara më lartë, me respekt i kërkojmë Autotitetit Kontraktues, që pas shqyrtimit të kësaj Kërkese për rishqyrtim të nxjerr këtë:

VENDIM

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR Kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik KIGA SHPK.

II. KONSTATOHET se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 par. 4.8 të Ligjit të Prokurimit Publik kur ka eliminuar Kiga SHPK për shkak të vërtetimit tatimor.

III. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 18.04.2025 dhe lënda i dërgohet komisionit për RIVLERËSIM.

Për dhe në emër të Kiga SHPK:

_____

Isuf Zejna, Avokat

4. **Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ *Jo* ☒

6. ***Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve***

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

II. BAZA JURIDIKE PËR APROVIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

6. Çështja e plotësimit të kritereve të pranueshmërisë së ofertuesve është e rregulluar në detaje me nenin 65 [Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve] në të cilin nen, paragrafi 4 përcakton: "Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik [...] 4.8. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë".

7. Më tutje kjo çështje është sqaruar dhe interpretuar edhe nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (tutje: KRPP) ku në interpretimin e datës 22.11.2022 sqarohet: "KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 "aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;" Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi "aktualisht" nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në

aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë "të pranueshëm" për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë "të pranueshëm" kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë "Deklaratën nën betim" me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "i pranueshëm" OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë."

8. Nga interpretimi i cekur si më lart, kuptohet se Parashtruesi i kërkesës Kiga ShPK ka plotësuar të gjitha kushtet e tenderit, pasi që në datën e publikimit të njoftimit për kontratë, ka pasur vërtetimin tatimor valid dhe nuk ka ekzistuar asnjë arsye për eliminimin tanë. Duke marrë parasysh këtë, autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 59 kur ka eliminuar ofertën tonë, pasi që në këtë dispozitë përcaktohet qartë se: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Për më tepër në nenin 52 par 3 përcaktohet: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike."

9. Duke eliminuar ofertën e Parashtruesit të kërkesës, Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Nenit 7 [Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi], në të cilën përcaktohet: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente." Në rastin konkret, duke na eliminuar si ofertë e papërgjegjshme, përkundër se ishim oferta më e lirë në këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues përveç diskriminimit tonë si operator, bënë edhe dëmtimin e buxhetit të institucionit pasi që përzgjedh për fituese një ofertë dukshëm më të shtrenjtë sesa kjo e Parashtruesit të kërkesës dhe në këtë mënyrë vepron në shkelje të nenit 1 dhe 6.

Prandaj, duke marrë përbazë të gjitha argumentet e theksuara më lartë, me respekt

i kërkojmë Autotitetit Kontraktues, që pas shqyrtimit të kësaj Kërkese për rishqyrtim të nxjerr këtë:

VENDIM

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR Kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik KIGA SHPK.

II. KONSTATOHET se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 par. 4.8 të Ligjit të Prokurimit Publik kur ka eliminuar Kiga SHPK për shkak të vërtetimit tatimor.

III. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 18.04.2025 dhe lënda i dërgohet komisionit për RIVLERËSIM.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenet e shkelura:

Neni 1

Neni 6

Neni 7

Neni 52

Neni 59

Neni 65

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. **APROVOHET si e bazuar Ankesa e operatorit ekonomik KIGa SHPK me adrese ne Fushe Kosove**

II. **KONSTATOHET** se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin të Ligjit të Prokurimit Publik kur ka eliminuar Kiga SHPK për shkak të vërtetimit tatimor.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 18.04.2025 dhe lënda i dërgohet komisionit për **RIVLERËSIM**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet e perkatitjes se ofertes
Sigurimi i tenderit
Shpenzimet e Avokatise
Shpenzimet e Ankeses

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*